



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN**  
**DREJTORATI I INSPEKTORATIT**



**DREJTORATI I INSPEKSIONIT**

<b>Datë :</b>	<b>05.05.2025</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/5</b>
<b>Për :</b>	<b>Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Nga:</b>	<b>Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit</b>
<b>Lënda :</b>	<b>Raporti i muajit-maj</b>

## **PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Gjatë muajit maj Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- Janë inspektuar biznese të ndryshme afariste, objektivi i inspektimit ka qenë regjistrimi i bizneseve, pranimi teknik i lokaleve në të cilat realizohet biznes, urdhëresat për pranimit teknik, si dhe realizimi i pranimeve teknike pas plotësimit të kriterëve.

Janë realizu inspektime në markete për të vërtetu përputhshmërinë e çmimeve raft-arkë dhe për vendosjen e flamujve tregues të origjinës.

Ankesat e pranuar nga konsumatorët të cilët kanë hasur në parregullsi gjatë blerjes i kemi trajtuar siç parashihet me ligj.

Në bashkëpunim me policinë në ANP "Adem Jashari" janë inspektuar Rentat ilegal, ku janë gjobitur për veprimet për ushtrimin e veprimtarive dhënia me qira e veturave në mënyrë ilegale. Po ashtu gjatë muajit është inspektuar tregu i gjelbër, i kafshëve dhe tregu i produkteve jo ushqimore.

Inspektori i mjedisit-ambientit- sipas rregullores komunale, për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, janë ri inspektuar të gjitha bizneset në qytet të cilët shfrytëzojnë hapësirën publike. Janë pajisur me pëlqim pothuaj të gjitha bizneset, vetëm 4 biznese për shkak të aplikimi me vonesë janë duke u shqyrtuar lëndët e tyre për marrjen e pëlqimit për hapësirën në shfrytëzim.

Janë inspektuar disa deponi ilegale të mbeturinave, në fshatrat Smallushë, Gadime e Ulët, Shalë për të marrë masa ligjore ndajë ndotësve të cilët takohen apo gjeten dëshmi për ndotjen e shkaktuar. Janë ri inspektuar dy biznese në Rr. "Sadik Shala" dhe Rr. "Haxhi Klecka", e që ri kontrolla ishte zbatimi i urdhëresave të dhëna ditë më parë, grumbullimi i mbeturinave dhe dorëzimi i tyre K. Pastrimi. Urdhëresat ishin zbatuar nga bizneset.

Janë shqyrtuar ankesat e pranuar nga qytetaret, ankesat ishin në fshatrat Baicë, dhe Magurë për shkarkim të ujërave të zeza në lumë, hedhje të materialit nga ndërtim demolomi në rrugë, kullosje të bagëtive në hapësira publike. Për rastet në fjalë janë dhënë urdhëresa të sanohen parregullsitë brenda një afati të caktuar, në të kundërtën do të pasojnë masat ligjore.

Janë bërë kontrolla ri kontrolla tek objektet banesor në ndërtim e sipër në Lipjan, objektet në Rr. "Fehmi Agani" Rr. "Hamdi Bislimi" Rr. "Haradin Bajrami" në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale, gjatë kontrollave nuk u gjetë ndonjë parregullsi.

Inspektorët e trafikut- Janë inspektuar firmat e autobusëve në disa fshatra për rendin e udhëtimit, taksitë individual dhe kompanitë taksi. Inspektime janë realizuar edhe në ANP-“Adem Jashari”. Po ashtu janë bërë disa pika kontrolli në Lipjan ku kemi ndaluar një kombi-taksi pa licenc dhe disa auto taksi pa licenc në Aeroportin “Adem Jashari” për çdo parregullsi janë marr të gjithë hapat procedural ligjor.

Inspektori i ndërtimit- Inspektori i ndërtimit gjatë këtij muaji ka inspektuar në teren objektet të ndryshme ndërtimi përgjatë zonave urbanistike, si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore.

Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal si dhe ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi është konstatuar gjendja me procesverbal dhe aktvendim për ndalimin e punëve dhe vendosjen e shiritave zyrtar. Nga inspektori i ndërtimit janë realizu, procesverbale, fletëparaqitje dhe vendosje të shiritave, gjoba mandatorë si dhe një kallëzim penal..

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët në formë të shkruar, elektronike apo përmes telefonatës.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit maj janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike te lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Gjoba mandatore.

Aktvendime.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoha mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektime për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	159	34	9					57	17				4	250.00€	6	12	8		9	3
Ambienti	38	10			3			9	10									3	3	
Ndërtimi	19	5			7	3			4											
Trafiku	19	3					9	3	1			1				2				
Gjithsej	235	52	9		10	3	9	69	32			1	4	250.00€	6	14	8	3	12	3

## **DISKUTIMET PUBLIKE**

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

## **TAKIME TË TJERA**

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

## **SFIDAT**

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

## **REKOMANDIMET**

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.